



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE E GJILANIT**  
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

---

**AD.GJTH.GJL.nr.19/24**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, duke vepruar sipas ankesës së datës 01.10.2024<sup>1</sup> të parashtruar nga ankuesi E. S. nga Gjilani, Rr. “Ahmet Krasniqi”, nr.1, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës M. Sh. – gjyqtare në Gjykatën Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm dhe gjyqtarit A. A. – gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, më datë 17.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET e pabazuar** ankesa e parashtruar nga ankuesi E. S. nga Gjilani, e datës 01.10.2024, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës M. Sh. – gjyqtare në Gjykatën Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm dhe gjyqtarit A. A. – gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**A r s y e t i m**

Më datë 01.10.2024, parashtruesi i ankesës E. S. ka paraqitur ankesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke theksuar se është diskriminuar nga gjyqtarët e kësaj gjykate, përkatësisht nga gjyqtarja M. Sh., e cila për 3 minuta pa lexim të aktakuzës dhe pa avokat ka shqyrtuar 3 lëndë gjyqësore dhe nga gjyqtari A. A. për lëndën Pn.617/219 i cili tenton pa thirrje, për çka ka protestuar në gjykatë.

Pas shqyrtimit të ankesës, bazuar në nenin 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, autoriteti kompetent konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar dhe nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore.

Pretendimet e ankuesit nuk konsistojnë në shkeljet disiplinore të parapara me këtë ligj, pasi sa i përket gjyqtarës M. Sh., kryetari i gjykatës ka konstatuar se në lëndët P.nr.657/19, P.nr.536/20 dhe P.nr.790/19, të mbajtura më datë 20.08.2024, në procesverbalet që gjenden në shkresat e lëndës është

---

<sup>1</sup> Përcjellur përmes lëndës pretendime për shkelje disiplinore, nr.01/973 më datë 11.10.2024 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe pranuar në Gjykatën Themelore në Gjilan më datë 15.10.2024.

evidentuar se është ftuar prokurorja e shtetit për ta lexuar aktakuzën dhe deklarimi i të pandehurit se e ka kuptuar aktakuzën dhe që pajtohet që mbrojtjen ta paraqes vet, si dhe i njëjti ka pranuar fajësinë për këto lëndë sipas aktakuzës lëndore.

Sa i përket gjyqtarit A. A., nga kjo ankesë nuk mund të konstatohet se cila është shkelja e pretenduar disiplinore dhe cilat janë ato veprime të ndërmarra që nuk janë të parapara me dispozitat ligjore, pasi në sistemin SMIL nuk figuron ndonjë lëndë me numrin P.nr.617/219.

Ankuesi në anën tjetër ka të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike ligjore për të kundërshtuar një vendim që e konsideron jo të drejtë dhe të ligjshëm, e në rastin konkret pretendimet e të njëjtit janë të orientuara në këtë drejtim dhe nuk mund të prodhojnë efekt në procedurë disiplinore, e gjithashtu nuk mund të konsiderohen si veprime në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

Andaj kryetari i kësaj gjykate, konform nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, ka gjetur se ankesa e parashtruesit E. S. nga Gjilani, e datës 01.10.2024, është e pabazuar dhe për të njëjtën ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Kryetari i Gjykatës,  
Venhar Salihu**

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Parashtruesit të ankesës,
2. KGJK-së
3. Dosjës së lëndës.